



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave
Divizioni për Koordinim të Politikave

Raport i Punës së
Ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal
Janar-Mars 2020

Prishtinë, Prill 2020

Ky raport paraqet punën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL për periudhën Janar-Mars të vitit 2020.

Raporti përshkruan aktivitetet e të gjitha njësive organizative të MAPL-së duke u fokusuar në katër fusha kryesore, të cilat përbëjnë objektivat e punës së ministrisë sipas planit vjetor për vitin 2020.

Raporti është hartuar nga Divizioni për Koordinim të Politikave.

Saktësia e të dhënave është përgjegjësi e departamenteve dhe njësive organizative të MAPL-së.

Përmbajtja

Shkurtesat.....	5
Hyrje.....	6
Përmbledhje ekzekutive	7
Veprimet e ndërmarra nga MAPL me rastin e shfaqjes së Coronavirusit COVID – 19.....	10
Veprimet e ndërmarra nga MAPL për stafin civil (të brendshëm) me rastin e COVID -19	10
Veprimet e ndërmarra nga MAPL në raport me komunave me rastin e COVID -19.....	11
Rritja e zhvillimit ekonomik lokal përmes mbështetjes financiare të komunave të bazuar në performancë	13
Zhvillimi i kuadrit strategjik për zhvillim ekonomik lokal	13
Financimi i projekteve të komunave	13
Vlerësimi i performancës komunale.....	13
Avancimi i bashkëpunimit ndërkomunal, komunal ndërkombëtar dhe ndërkufitar.....	16
Bashkëpunimi ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar	16
Zbatimi i programeve të bashkëpunimit ndërkufitar.....	16
Avancimi i politikave dhe i kornizës ligjore për vetëqeverisje lokale.....	18
Zhvillimi i akteve ligjore dhe nënligjore.....	18
Vlerësimi i ndikimit të politikave në fushën e vetëqeverisjes lokale.....	18
Monitorimi i kuvendeve të komunave	19
Adresimi i obligimeve nga agjenda evropiane.....	19
Koordinimi i politikave	20
Zbatimi i rekomandimeve të auditorit	21
Ngritja e transparencës komunale, promovimi i të drejtave të njeriut dhe zhvillimi i kapaciteteve	22
Aktivitetet në fushën e të drejtave të njeriut	22
Forcimi i transparencës komunale.....	22
Informimi i publikut për aktivitetet e MAPL-së.....	23
Raporti për qasjen në dokumentet publike në komuna	23
Krijimi i platformës së kontrollit të brendshëm dhe transparencës buxhetore	24

Platforma e brendshme e raportimit	24
Bashkëpunimi me shoqërinë civile	24
Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunal	25
Administrata, financat dhe prokurimi.....	26
Administrata dhe financat.....	26
Prokurimi.....	27

Shkurtesat

AE	Agjenda Evropiane
BB	Banka Botërore
BIRN	Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
IE	Integrimet Evropiane
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës
LVL	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MPBAP	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
MF	Ministria e Financave
MSA	Marrëveshja për Stabilizim Asociim
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PL	Pushteti Lokal
PQ	Pushteti Qendror
QOE	Qendra Operative Emergjente
QOMPAB	Qendra Operative Emergjente e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
QPKS	Qendra për Parandalim dhe Kontroll të Sëmundjeve
SDC/DEMOS	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SIDA	Agjensioni Suedez për Zhvillim Ndërkombëtar
SMFK	Sistemi i Menaxhimit të Performancës Komunale
SVL	Strategjia për Vetëqeverisje Lokale
SZHEL	Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
USAID	Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar
ZPS	Zyra për Planifikim Strategjik

Hyrje

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në përputhje me mandatin e saj ligjor, objektivat e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016–2026, si dhe Planin Vjetor të Punës për vitin 2020, ka realizuar aktivitetet e planifikuara për periudhën Janar - Mars 2020. Raporti pasqyron arritjet sipas fushave të përcaktuara në këtë plan, të integruara edhe në Planin Vjetor të Punës së Qeverisë për vitin 2020. Aktivitetet e raportuara zënë vend në pesë objektivat kryesore të punës, si vijon:

- Rritja e zhvillimit ekonomik lokal përmes mbështetjes financiare të komunave të bazuar në performancë;
- Avancimi i bashkëpunimit ndërkomunal, komunal ndërkombëtar dhe ndërkufitar;
- Avancimi i politikave dhe i kornizës ligjore për vetëqeverisje lokale;
- Ngritja e transparencës komunale, promovimi i të drejtave të njeriut dhe zhvillimi i kapaciteteve
- Administrata dhe financat, auditimi dhe prokurimi.

Raporti bazohet në të dhënat e raportuara për aktivitetet e realizuara nga departamentet dhe njësitë/divizionet e MAPL-së, respektivisht:

- Departamentit për Zhvillim të Qëndrueshëm Komunal;
- Departamentit për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe Ndërkufitar;
- Departamentit për Integrimi Evropiane dhe Koordinim të Politikave;
- Departamentit Ligjor dhe për Monitorim të Komunave;
- Departamentit për Performancë dhe Transparencë në Komuna;
- Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
- Divizioni për Komunikim me Publikun;
- Divizioni i Auditimit të Brendshëm;
- Divizioni i Prokurimit.

Lidhur me metodologjinë e raportit, janë marrë për bazë informatat nga njësitë përkatëse të MAPL-së, të cilat janë analizuar dhe janë vendosur sipas objektivave dhe aktiviteteve të caktuara në planin vjetor të punës. Raporti merr për bazë indikatorët sasior dhe cilësor për aktivitetet realizuara dhe është raport deskriptiv mbi aktivitetet e MAPL-së gjatë periudhës 3 mujore (Janar – Mars 2020).

Përmbledhje ekzekutive

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në periudhën Janar – Mars 2020 ka arritur t'i realizoj aktivitetet e parapara të cilat janë pjesë e planit vjetor të punës së MAPL-së për këtë vit. Ky plan është dokument i bazuar në objektivat kryesore të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 dhe në dokumentet tjera relevante të qeverisë. Në periudhën tremujore Janar – Mars 2020 është shënuar progres i matshëm në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, plotësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor për vetëqeverisje lokale, përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve komunale, forcimin e transparencës komunale, promovimin e barazisë gjinore, e-qeverisjes, zgjerimin e bashkëpunimit me partnerët/donatorët përmes projekteve të përbashkëta, bashkëpunimi me shoqërinë civile, përmirësimin e koordinimit ndërsektorial, bashkëpunimin ndërkomunal, komunal ndërkombëtar dhe ndërkufitar, ngritjen e kapaciteteve profesionale të komunave dhe shumë fusha të tjera edhe pse një pjesë e aktiviteteve janë zhvilluar nga distanca për shkak të pandemisë së COVID 19.

Pas shfaqjes së Coronavirusit COVID – 19 si pandemi globale, marrjes së masave adekuate nga Qeveria e Kosovës, MAPL ka pasur një rol të rëndësishëm në koordinimin dhe zhvillimin e aktiviteteve ndërinstitucionale dhe në raport me komunat. MAPL ka përgatitur Planin e Veprimit për ndërmarrjen e masave konkrete lidhur me pandeminë globale Coronavirus COVID – 19. Janë njoftuar të gjithë zyrtarët e MAPL-së lidhur me vendimet e Qeverisë dhe janë përgatitur udhëzimet e nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve nga zyrtarët përmes distancës/shtëpisë. Në vazhdimësi komunat janë informuar rreth situatës së pandemisë në vend, janë adresuar në komuna një sërë kërkesash dhe njoftimesh nga Qendra Operative Emergjente, Qendra Operative e Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike dhe Qendra për Parandalim dhe Kontroll të Sëmundjeve. Gjatë kësaj periudhe, janë vizituar komunat e prekura nga pandemia dhe komunat tjera, për të ofruar mbështetje dhe për të parë nevojat dhe kërkesat e tyre, si dhe t'i adresuar ato tek institucionet gjegjëse, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, në mënyrë që të ketë një menaxhim më efikas të pandemisë së COVID – 19. Vizitat kryesisht janë realizuar nga ministrja e MAPL-së zj. Emilija Redzeqi.

Në kuadër të zhvillimit të politikave për Vetëqeverisje Lokale, fokusi është vënë në monitorimin e Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal dhe është përgatitur draft raporti lidhur me implementimin e planit të veprimit të Strategjisë për Zhvillim ekonomik Lokal. Në kuadër të Projektit me Bankën Botërore “Përfshirja e të Rinjve në Zhvillimin Ekonomik Lokal” janë realizuar 5 takime lidhur me fillimin e projektit dhe procedurat, si dhe është nënshkruar Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore. Lidhur me financimin e projekteve në komuna nga programi për zhvillim të infrastrukturës socio ekonomike janë përgatitur kriteret për financim dhe është lansur thirrja për aplikim në ueb faqe të MAPL-së. Janë ndërmarrë 6 iniciativa për bashkëpunim ndërkomunal, ndërsa, në kuadër të bashkëpunimit ndërkomunal ndërkombëtar, janë ndërmarrë 2 iniciativa, si dhe 1 marrëveshje është nënshkruar. Njëkohësisht ka vazhduar zbatimi i programeve të bashkëpunimit ndërkombëtar IPA II: Shqipëri - Kosovë, Mal i Zi -Kosovë dhe Kosovë Maqedoni.

Në këtë periudhë Janar- Mars 2020, MAPL fokus të veçantë i ka dhënë akteve nënligjore në programin legjislativ për vitin 2020 dhe dokumenteve tjera, përfshirë këtu ndryshimin/plotësimin e 6 akteve nën ligjore dhe vlerësimin Ex-post të Ligjit për zgjedhje lokale, të cilat janë në proces si rezultat i pandemisë së COVID 19. Ndërsa në mbështetje të SDC/DEMOS, është hartuar Raporti mbi studimin e Fizibilitetit të Vetëqeverisjes Lokale dhe ka filluar faza e dytë e studimit të fizibilitetit e cila do të jep alternativat për zhvillimin dhe avancimin e mëtutjeshëm të vetëqeverisjes lokale në Kosovë.

MAPL ka monitoruar 93 mbledhje në 38 kuvende të komunave, prej tyre 85 mbledhje të rregullta, 4 të jashtëzakonshme dhe 4 mbledhje solemne. MAPL ka monitoruar përmes teleprezencës 88 mbledhje të mbajtura ose 94.6% e tyre, kurse 5 mbledhje të tjera janë monitoruar me prezencë fizike të zyrtarëve për monitorim në komunat. Kuvendet e komunave kanë aprovuar gjithsej 330 akte. Prej tyre, 122 janë proceduar për vlerësim të ligjshmërisë në ministrinë e linjës, kurse 208 janë shqyrtuar nga MAPL. 100 % e akteve të kuvendeve u janë nënshtruar procesit të shqyrtimit administrativ të ligjshmërisë. Gjatë procesit të shqyrtimit të ligjshmërisë janë konstatuar 17 akte të kundërligjshme të kuvendeve të komunave, për të cilat janë dërguar 17 kërkesa për rishqyrtim. Si rrjedhojë 4 akte janë harmonizuar nga kuvendet e komunave (apo 23%), ndërsa 9 janë brenda afatit kohor për rishqyrtim (53% në proces). MAPL ka ndërmarrë veprimet procedurale për kundërshtim të 4 akteve (apo 23%) në gjykatën themelore, përmes Ministrisë së Drejtësisë. Me qëllim të pasqyrimin të aktiviteteve të zhvilluara nga kuvendet e komunave është hartuar dhe publikuar Raporti i funksionimit të kuvendeve të komunave për periudhën Janar - Dhjetor 2019. MAPL ka udhëhequr një proces tejet të rëndësishëm për adresimin e obligimeve të agjendës evropiane në komuna. Në kuadër të raportit të përmbushjes së obligimeve nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar-Dhjetor 2019 rezultatet që dalin sipas kritereve janë: Kriteret politike 71% të masave, Kriteret ekonomike 71% të masave, Standardet Evropiane 66% të masave.

Lidhur me zbatimin e politikave në fushën e të drejtave të njeriut, MAPL ka vazhduar me mbështetjen e komunave. Sa i përket fushës së promovimit të barazisë gjinore në komuna, është rritur ndërgjegjësimi i zyrtarëve komunal për nevojën e hapave konkrete në integrimin e perspektivës gjinore në politikat komunale, ku në vazhdimësi MAPL ka bërë përpjekje që komunat të arrijnë sigurimin e përfaqësimit gjinor në përputhje me kuadrin ligjor.

Forcimi i transparencës dhe qeverisja elektronike kanë qenë ndër objektivat kryesore, gjatë kësaj periudhe. Në këtë fushë MAPL ka finalizuar planin e monitorimit për transparencë në komuna dhe janë identifikuar të gjithë treguesit e transparencës që dalin nga legjislacioni primar dhe sekondar. Ka vazhduar monitorimi i ueb-faqeve të komunave për të parë nivelin e përmbushjes së obligimeve për informimin e publikut sipas kritereve të kërkuara ligjore. Është hartuar raporti Janar -dhjetor 2019 i monitorimit të ueb-faqeve të komunave. Sipas të dhënave komunat kanë publikuar rreth 68% të rregulloreve të aprovuara dhe janë publikuar vetëm 52% e procesverbaleve të mbledhjeve të kuvendeve të komunave. Në fushën e performancës komunale, në tremujorin e parë të vitit 2020 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bashkëpunim partnerët e saj strategjik SDC-DEMOS, SIDA dhe Ambasadën Norvegjeze në Kosovë, kanë përmbyllur procesin e përzgjedhjes së komunave përfituese nga granti i paraparë i performancës komunale për vitin 2020. Përmes Komisionit të Grantit të Performancës Komunale është bërë përzgjedhja e 23 komunave përfituese të 4.9 milion eurove nga granti i performancës komunale, prej të cilave 2.5 milion janë ndarë nga MAPL, 950,000 euro SDC, 540,000 Qeveria Suedeze dhe 910,000 Qeveria Norvegjeze.

Gjatë periudhës Janar – Mars 2020 në mbështetje të Ambasadës Britanike, përmes partnerit zbatues “BIRN”, është implementuar projekti monitorues pozitave të shërbyesve civil, sa i përket procesit të rekrutimit. Ndërsa, në bashkëpunim me Ambasadën Britanike dhe UNDP-në kanë arritur krijimin e platformës së kontrollit të brendshëm dhe transparencës buxhetore, UNDP ka nënshkruar kontratën me kompaninë përfituese *Komtel Project Engineering*. Në vazhdimësi janë ofruar informata për publikun dhe palët e interesuara lidhur me aktivitetet e zhvilluara të MAPL-së si: lajme, aktivitete ditore, video, informata të publikuara në Facebook, Twitter, etj,

Në kuadër të aktiviteteve për fuqizimin e kapaciteteve të administratës publike, MAPL në bashkëpunim me IKAP dhe donatorët (GIZ, UNDP, USAID, OSBE, DEMOS) ka realizuar trajnime në 5 komunat regjionale të Republikës së Kosovës me temën “*Komunikimi i masave të MSA-së në nivel lokal*”, ku pjesëmarrës kanë qenë 80 zyrtarë komunal. Për të forcuar bashkëpunimin me shoqërinë civile, MAPL ka përfshirë shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe legjislacionit për vetëqeverisje lokale, gjithashtu gjatë periudhës së parë të vitit 2020 është zhvilluar një takim i përbashkëta me shoqërinë civile në kuadër të Forumit Konsultativ. Në këtë periudhë, administrata në MAPL ka ofruar ndihmë në përkthim të materialeve, dokumenteve të ndryshme në gjuhën serbe dhe angleze, është ofruar përkthim simultan në takime të ndryshme të cilat kanë i kanë zhvilluar njësitë e MAPL-së. Janë ofruar shërbime në transport, shpërndarje të materialeve të ndryshme dhe fotokopje. Buxheti i MAPL-së për vitin 2020 është 4,893,832.89 €, ku nga kjo shumë për këtë periudhë tremujore (Janar – Mars 2020) janë shpenzuar 260,057.21 € ose 5.60% e buxhetit. Në fushën prokurimit janë zhvilluar 5 aktivitete sipas planifikimit për këtë periudhë.

Veprimet e ndërmarra nga MAPL me rastin e shfaqjes së Coronavirusit COVID – 19

Veprimet e ndërmarra nga MAPL për stafin civil (të brendshëm) me rastin e COVID -19

Pas shfaqjes së coronavirusit COVID – 19 si pandemi globale, institucionet e Republikës së Kosovës kanë marrë masat adekuate dhe të nevojshme për parandalimin e përhapjes së tij. Fillimisht, Qeveria ka nxjerrë vendimin Nr. 01/07 të datës 11.03.2020 për parandalimin e infeksionit Coronavirus COVID – 19 dhe ndërmarrjen e masave, duke bërë kështu që të gjitha institucionet e vendit të kenë një gatishmëri për situatën pandemike. Ndërsa, me datë 12 Mars 2020 MAPL ka mbajtur takimin e parë koordinues me stafin menaxherial dhe ka përgatitur Planin e Veprimit të MAPL-së për ndërmarrjen e masave konkrete lidhur me pandeminë globale Coronavirus COVID – 19. Po ashtu, është përgatitur Lista prioritare për fazën emergjente për MAPL-në, duke përfshirë këtu:

- Përgatitjen e listës nga secili Departament/Njësi me emra të zyrtarëve të cilët do të qëndrojnë në vendin e punës dhe zyrtarët të cilët do të lirohen në shtëpi, si dhe identifikimin e zyrtarëve të cilët mund të kenë simptoma të gripit, si masë parandaluese në mënyrë që të lirohen në shtëpi. Kurse, për çështjet të cilat lidhet me aktivitetet e punës, zyrtarët të punojnë nga shtëpia,
- Aktivitetet të cilat janë me afate kohore, si vlerësimet e ligjshmërisë së akteve, çështje të pagesave, raporteve prioritare, duhet t'i epet prioritet dhe të kryhen sipas afateve kohore. Aty ku ka mungesë të stafit në ndonjë departament, obligohen departamentet e tjera të bëjnë mbulimin e tyre, koordinimin dhe bashkëveprim e punëve ndërmjet tyre,
- Janë anuluar të gjitha takimet e brendshme dhe të jashtme, përfshirë grupet punuese, konferencat, tubimet, udhëtimet zyrtare,
- Po me këtë datë, është adresuar kërkesa në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike për dezinfektim të hapësirave të vendeve të punës/Ndërmarrja e masave parandaluese të infeksionit Corona Virus COVID – 19 dhe është adresuar kërkesa në Ministrinë e Shëndetësisë për sigurim të pajisjeve higjienike dhe mbrojtëse/ Ndërmarrja e masave parandaluese të infeksionit Corona Virus COVID – 19.
- Është finalizuar “*Lista prioritare për fazën emergjente dhe masat parandaluese*”, e cila është përkthyer në gjuhën serbe dhe cila iu është dërguar të gjithë stafit të MAPL-së, si dhe është përgatitur lista tjetër “*Lista e stafit esencial që do të dalin në punë dhe e atyre që do të vazhdojnë punën on-line nga shtëpia*”, me qëllim të ruhet shëndeti i zyrtarëve dhe aktivitetet më pastaj të realizohen nga shtëpia përmes mjeteve të teknologjisë informative.

MAPL, duke parë situatën pandemike në vend, me datë 16 Mars 2020, ka mbajtur takimin e radhës koordinues me stafin menaxherial, me ç'rast janë vendosur dy detyra obliguese për stafin e MAPL-së dhe të njëjtat janë dërguar tek stafi për njoftimin e tyre, si: a) Obligohet Divizioni i TI-së dhe Shërbimeve Logjistike për krijimin e linkut të përshtatshëm për komunikim on-line për stafin menaxherial; dhe b) Obligohet secili departament/njësi organizative të njoftoj stafin e vetë të cilët janë të liruar në shtëpi, të vazhdojnë punën e tyre përmes llatopëve dhe qasjes në e-mailin zyrtar. Po në të njëjtën datë, Sekretarja e Përgjithshme e MAPL-së, ka nxjerr Vendimin me Nr. 02-269-2020 për themelimin e Grupit Operativ në kuadër të MAPL-së për parandalimin e infeksionit të Coronavirus COVID-19, si dhe me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve tjera

MAPL ka adresuar kërkesën në MPBAP “Përgatitja e Qarkores Informuese” lidhur me procedurat administrative dhe procedurat e rekrutimit për pozitat e lira.

Veprimet e ndërmarra nga MAPL në raport me komunave me rastin e COVID -19

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal konform përgjegjësi që ka dhe sipas objektivave të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale, misionit dhe vizionit, gjatë kësaj periudhe rol të rëndësishëm i ka kushtuar edhe komunave, me qëllim të përkrahjes dhe marrjes së masave adekuate për parandalimin e pandemisë globale të COVID -19. Në këtë drejtim, MAPL ka adresuar një sërë kërkesash dhe njoftimesh tek kryetarët e komunave, kryesuesit e kuvendeve të komunave, Qendra Operative Emergjente (QOE), Qendra Operative e MPBAP (QOMPAP) dhe Qendrën për Parandalim dhe Kontroll të Sëmundjeve (QPKS) me prioritetet, si në vijim:

- Është adresuar Plani i gatishmërisë dhe reagimit të institucioneve për COVID-19, si dhe janë vënë në dispozicion pikat e kontaktit të MAPL-së për Komunitat lidhur me adresimin e kërkesave të tyre;
- Janë njoftuar komunitet që deklarimet/informatat e tyre publike të jenë të kujdesshme dhe në harmoni të plotë me informatat zyrtare që dalin nga dy institucionet kryesore, Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, si dhe vendimet e mbledhjes së 9 –të të Qeverisë së Kosovës.

Ndërsa, me qëllim të ofrimit të përkrahjes dhe mbështetjes së nevojshme për pushtetin lokal, MAPL, respektivisht ministrja Emilija Redzeqi fillimisht ka realizuar vizitë në komunat e prekura me Coronavirus COVID – 19, komunat: Klinë, Viti dhe Malishevë, në mënyrë që të njoftohet me kërkesat dhe nevojat e këtyre komunave dhe t’i adresoj ato tek Qeveria e Kosovës, pastaj komunat: Mitrovicë e Jugut, Pejë dhe Istog, ku janë diskutuar parapërgatitjet e domosdoshme për tejkalimin e problemeve ekonomike dhe sociale të cilat janë shfaqur dhe do të shfaqen edhe pas situatës së krijuar. Më tej, është realizuar edhe vizita në komunën e Dragashit me përfaqësuesit e komunës për të diskutuar situatën aktuale të COVID – 19 dhe adresimin e kërkesave të tyre tek Ministria e Shëndetësisë për tu pajisur me pajisje mbrojtëse dhe higjienike. Të njëjtat kërkesa janë adresuar tek Ministria e Shëndetësisë edhe për komunat: Mitrovicë e Veriut, Shtërpçë, Ranillug dhe Zveçan.

Në këtë periudhë, në mënyrë që të informohet niveli lokal rreth vendimeve dhe masave adekuate rreth pandemisë në vend, MAPL ka dërguar në komuna Qarkoren për Informim të institucioneve Shëndetësore Publike dhe Private në Republikën e Kosovës Nr. 05/2020, manualin e regjistrimit on-line për paraqitjen e kërkesës për certifikata të gjendjes civile në gjuhët zyrtare dhe manualin për përdorimin e Intranetit Komunal, po ashtu në gjuhët zyrtare. Gjithashtu, është dërguar tek komunat kërkesa për ngritjen e ekipeve mjekësore në zonat kufitare, letra njoftuese për kryetarët e komunave për masat kundër Coronavirusit COVID – 19 dhe kërkesa për sigurimin e informatave dhe të dhënave tjera relevante për: numrin e kontakteve të personave të ardhur nga diaspora për secilën komunë, si dhe për emrin e vendbanimit, fshatit dhe lokacionit. Pas marrjes së informatave adekuate nga komunat: Malishevë, Deçan, Suharekë, Hani i Elezit, Mamushë, Viti, Istog, Drenas, Klinë, Obiliq, Podujevë dhe Skenderaj, ato janë adresuar në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe është bërë njoftimi për pezullimin e përkohshëm të të gjitha shqyrtimeve të ligjshmërisë së akteve të organeve komunale, njoftimi mbi vendimet e mbledhjes së 11 dhe 12 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, njoftimi rreth udhëzimeve, rekomandimeve dhe PSO-të e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik

të Kosovës, janë dhënë sqarimet mbi zbatimin e Urdhërësës Nr. 01/03 të datës 17.03.2020 (MEPTINIS) për zbatimin e masave ndaj veprimtarive ekonomike lidhur me emergjencën e shëndetit publik, është bërë kërkesë për informatë lidhur me nevojat për tenda të komunave, është adresuar kërkesa urgjente nga Ministria e Shëndetësisë që komunat të dërgojnë kërkesat specifike për të gjitha pajisjet, mjetet mbrojtëse dhe aparaturat, si dhe janë njoftuar komunat lidhur me vendimin Nr. 05 - 1519 të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe me Urdhërësën Nr. 1589 të MEPTINIS-së.

MAPL, ka hartuar informatën lidhur me Coronavirusin COVID-19 dhe ka adresuar kërkesën prioritare në komuna në emër të Qendrës Operative të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, me qëllim të njoftimit se komunat duhet të jenë në kontakt të përhershëm me Qendrën Operative të MPBAP-së 24/7, për informim, mbështetje, ndihmë dhe këshilla. Njashtu, në emër të kësaj qendre është adresuar njoftimi tek komunat, se nuk është në kompetencën e tyre që të shpallin komunat e tyre si zona karantinë. Komunave iu është dërguar Qarkorja ligjore Nr. 02, me datë 23.03.2020 e MAPL-së, në mënyrë që zbatojnë Vendimet e Qeverisë për Parandalimin e Virusit COVID-19, si dhe është adresuar në QOMPBPAP kërkesa e Komunës së Graçanicës lidhur me ardhjen e mjekëve nga Serbia, kërkesë kjo e cila është aprovuar dhe mjekët kanë arritur në komunën Graçanicës.

Në vazhdimësi ka pasur një koordinim me Ministrinë e Shëndetësisë për adresimin e kërkesave nga komunat dhe anasjelltas me qëllim të menaxhimit të pandemisë së COVID – 19. Në këtë drejtim, MAPL ka adresuar në Ministri të Shëndetësisë kërkesën urgjente e Komunës së Vitisë lidhur me ofrimin e mbështetjes shtesë për dezinfektim të hapësirave dhe institucioneve publike, po ashtu janë adresuar tek komunat me shumicë serbe udhëzuesit e ECDC-së të cilat janë pranuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Komunat janë informuar në vazhdimësi rreth situatës së pandemisë në vend, është dërguar njoftimi i MAPL-së tek kryetarët e komunave dhe kryesuesit e kuvendeve të komunave lidhur me çështjen se MAPL do të adresojë në MFT vendimet e Kuvendeve të Komunave për vlerësim të ligjshmërisë, përkatësisht vendimet të cilat ndërlidhen me aspektet financiare, për të trajtuar çështjet që ndërlidhen me situatën emergjente për parandalimin e COVID-19. Gjithashtu, është dërguar në adresë të kryetarëve të komunave dhe kryesuesve të kuvendeve të komunave “Udhëzuesi Nr. 135/2020, i datës 24.03.2020 i MPBAP-së, pastaj “Vendimi i mbledhjes së 16 dhe 17-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës”, adresimi i shkresës zyrtare për “Themelimin dhe funksionalizimin e Komitetit Komunal për Reagim Emergjent (Shtabet Emergjente)”, Vendimi për pezullimin e trafikut urban i nxjerrë nga Qendra Operative e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, si dhe shkresa zyrtare tek komunat me shumicë serbe e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit lidhur me çështjen e organizimit dhe vazhdimin të procesit mësimor në shkolla në gjuhën serbe.

MAPL ka adresuar njoftimin/kërkesën Qendrës Operative të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike në adresë të kryetarëve të komunave lidhur me mundësinë e përkeqësimit të situatës në Kosovë për sa i përket përhapjes së Coronavirusit, si dhe kërkesën për funksionalizimin e Komiteteve Komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim (shtabet emergjente) dhe dërgimit të kontakteve të personave përgjegjës të komunave. Ndërkohë nga MPBAP është nxjerrë "Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzuesit të MPBAP-së Nr.135/2020, datë 24.03.2020", bazuar në kërkesën e pranuar nga kryetari i Komunës së Hanit të Elezit për plotësimin e listës me ndërmarrjet publike qendrore dhe lokale dhe i njëjti është adresuar tek Komuna e Hanit të Elezit.

Rritja e zhvillimit ekonomik lokal përmes mbështetjes financiare të komunave të bazuar në performancë

Aktivitetet e realizuara në kuadër të objektivit të parë, janë grupuar në 3 fusha kryesore si vijon:

- Hartimit të politikave për zhvillim ekonomik lokal;
- Financimit të projekteve të komunave;
- Menaxhimi i performancës komunale.

Zhvillimi i kuadrit strategjik për zhvillim ekonomik lokal

Pas aprovimit të Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal 2019 – 2023 nga Qeveria, MAPL së bashku me akterët tjerë të përfshirë ka nisur së implementuari strategjinë në fjalë. Për këtë qëllim në periudhën e tremujorit të parë të vitit 2020 në kuadër të monitorimit të strategjisë është dërguar shkresa tek komunat dhe ministrinë e linjës ku janë bartëse të aktiviteteve në kuadër të planit të veprimit të strategjisë për të raportuar lidhur me realizimin e aktiviteteve të dala nga plani i veprimit të SZHEL. Bazuar në planin vjetor të punës për vitin 2020 dhe në të dhënat e pranura nga komunat dhe ministrinë e linjës, është përgatitur draft raporti lidhur me implementimin e planit të veprimit të Strategjisë për Zhvillim ekonomik Lokal i cili pas finalizimit do të dërgohet në Zyrën për planifikim strategjik.

Sa i përket Projektit me Bankën Botërore “Përfshirja e të Rinjve në Zhvillimin Ekonomik Lokal” gjatë periudhës Janar – Mars 2020 janë realizuar 5 takime lidhur me fillimin e projektit dhe procedurat. Sipas kërkesës së përfaqësuesit të projektit të Bankës Botërore janë përgatitur informata të ndryshme lidhur me procedurat buxhetore komunale. Kurse, me datën 27.02.2020 është nënshkruar marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore.

Financimi i projekteve të komunave

Programi për financimin e projekteve kapitale të komunave është një ndër instrumentet kryesore të mbështetjes direkte të komunave në fushën e zhvillimit ekonomik. Lidhur me financimin e projekteve në komuna nga programi për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike janë përgatitur kriteret për financim dhe është lansur thirrja për aplikim në ueb faqe të MAPL-së e cila thirrje është e hapur deri me datën 10.04.2020. Ndërsa, për programin bashkëfinancimi me donatorë bazuar në skemën e grantit për performancë të komunave janë shpallur 23 komuna fituese dhe me datën 04.04.2020 është publikuar komunikata në ueb faqen e MAPL-së dhe janë njoftuar të gjitha komunat përfituese.

Vlerësimi i performancës komunale

MAPL gjatë kësaj periudhe, rëndësi të madhe iu është kushtuar edhe avancimit të sistemit të performancës komunale dhe skemës së grantit të bazuar në performancë. Është kontraktuar nga DEMOS konsulenti që ka vlerësuar gjendjen e sistemit elektronik të SMPK-së, është hartuar raporti vlerësues ku identifikohen përparësitë dhe dobësitë e funksionimit të këtij sistemi. Po ashtu, janë hartuar propozimet teknike për shpalljen e thirrjes për ofertim lidhur me zhvillimin e këtij sistemi dhe projekti DEMOS do të kontrakttoj operatorin për zhvillim të sistemit elektronik, sipas thirrjes së hapur. Janë hartuar termat e referencës për

operatorët që duhet të zhvillojnë këtë sistem, si dhe janë bërë përgatitjet për veprim të grupit teknik që do të zhvilloj sistemin. Po ashtu, është përgatitur edhe pako e dokumenteve udhëzuese për fillimin e raportimit të të dhënave për vitin 2019, e cila do të dorëzohet në mesin e muajit Prill të vitit 2020.

Lidhur me ndarjen e granteve për komunat bazuar në performancë komunale, MAPL fillimisht ka themeluar Grupin Teknik për vlerësimin e Grantit të Performancës për vitin 2020, i cili përbëhet prej 7 anëtarëve (5 anëtarë nga MAPL dhe 2 anëtarë nga DEMOS). Në vitin 2020 granti do të ketë dy cikle të vlerësimit: a) Cikli I i cili ka të bëjë me grantin e vitit 2020 dhe i cili është përfunduar dhe ka marrë për bazë performancën e vitit 2018 dhe b) cikli II i cili do të fillon në Qershor dhe merr për bazë performancën e vitit 2019. Në tremujorin e parë të vitit 2020 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bashkëpunim partnerët e saj strategjik SDC-DEMOS, SIDA dhe Ambasadën Norvegjeze në Kosovë, kanë përmbyllur procesin e përzgjedhjes së komunave përfituese nga granti i paraparë i performancës komunale për vitin 2020. Përmes Komisionit të Grantit të Performancës Komunale është bërë përzgjedhja e 23 komunave përfituese të 4.9 milion eurove nga granti i performancës komunale, prej të cilave 2.5 milion janë ndarë nga MAPL, 950,000 euro SDC, 540,000 Qeveria Suedeze dhe 910,000 Qeveria Norvegjeze. Komunat janë kualifikuar në bazë të vlerësimit të performancës së arritur, mbështetur në Rregullat e Grantit të performancës komunale. Vlerësimi dhe përcaktimi i shumave financiare është bërë në një proces tejet transparent dhe gjithëpërfshirës, me pjesëmarrje aktive të të gjithë anëtarëve të Komisionit të Grantit, të përbërë nga: MAPL dhe MF si struktura vendimmarrëse, dhe anëtarëve të tjerë vëzhgues nga SDC-DEMOS, Ambasada Suedeze, Ambasada Norvegjeze dhe Instituti GAP. Raporti përmbledh informatat kyçe të performancës së komunave gjatë vitit 2018 dhe ndërlidhjes së këtyre rezultateve me indikatorët dhe komponentët e tjerë përcaktues të grantit. Tri kriteret e përdorura në këtë cikël të vlerësimit kanë qenë parakusht për qasje në grant. Sipas këtyre kriterëve, komunat është dashur që:

- Të kenë një opinion auditimi të paktën të pamodifikuar me theksim të çështjes;
- Të kenë shpenzuar 75% ose më tepër të buxhetit për investime kapitale; dhe
- Të kenë nënshkruar marrëveshjen tripalëshe të pjesëmarrjes (komuna, MAPL dhe HELVETAS Swiss Intercooperation).

Rezultatet tregojnë se kriteret minimale janë përmbushur nga 23 komuna: Pejë, Junik, Lipjan, Gillogoc, Kaçanik, Gjilan, Mitrovicë e Jugut, Vushtrri, Hani i Elezit, Klinë, Rahovec, Shtime, Skenderaj, Gjakovë, Suharekë, Malishevë, Viti, Graçanicë, Killokot, Ranillug, Shtërpcë, Mamushë, dhe Leposaviq. Përveç kësaj, Rregullat e Grantit parashohin një bonus prej 10% të totalit të grantit për 3 komunat me performancën më të mirë në ofrimin e shërbimeve. Si rrjedhojë, 3 komunat që kanë arritur numrin më të madh të pikëve sipas performancës janë: Komuna e Pejës – vendi i parë; Komuna e Junikut – vendi i dytë dhe Komuna e Lipjanit – vendi i tretë. Marrë parasysh kredibilitetin e këtij sistemi, MAPL do të vazhdoj edhe më tutje me matjen vjetore të performancës komunale dhe ndarjen e shpërblimeve për komunat më të suksesshme.

Gjithashtu, performanca mesatare e të gjitha 38 komunave në 18 treguesit e performancës për vitin 2018 (grantin e vitit 2018) është 45.6% (~26.4 pikë nga gjithsej 58 pikë të mundshme), ndërsa performanca mesatare e komunave që janë kualifikuar për grantin e performancës komunale është 48.28% (28 pikë nga gjithsej 58 pikë të mundshme). Dy komuna nuk i kanë raportuar të dhënat për performancën e vitit 2018 në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK). Rezultati i këtyre dy komunave për treguesit - burimi i të dhënave të të cilëve është SMPK - është zero. Ndërsa, për treguesit për të cilët burimi i të dhënave është Zyra Kombëtare e Auditimit, këto komuna kanë fituar pikë sipas performancës së tyre. Rezultati i

performancës së tyre e ka zvogëluar përqindjen mesatare të performancës për grantin e performancës komunale. Performanca mesatare e 36 komunave të cilat i kanë raportuar të dhënat e performancës së vitit 2018 në SMPK është 48.28% (3.45% më shumë krahasuar me mesataren e 38 komunave). Rezultati mesatar i treguesve të performancës së vitit 2018 për secilën komunë veç e veç është dhënë në figurën numër 2 më poshtë. 18 nga 38 komunat kanë arritur një performancë mesatare mbi 50% në 18 treguesit e performancës. 23 komuna janë përzgjedhur fituese të 4.9 milion euro. Komunitetët pritet të dorëzojnë projektet që do të financohen. Kurse, numri i projekteve që do të financohen varet nga komunitetët.

Avancimi i bashkëpunimit ndërkomunal, komunal ndërkombëtar dhe ndërkufitar

Aktivitetet në këtë objektiv janë realizuar në drejtim të:

- Forcimit të bashkëpunimit ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar
- Zbatimi të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar

Bashkëpunimi ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar

Në këtë periudhë Janar - Mars 2020 është finalizuar analiza dhe plani i veprimit lidhur me bashkëpunimin ndërkomunal. Publikimi i analizës dhe planit të veprimit do të bëhet pas mbajtjes së punëtorisë së planifikuar në bashkëpunim me OSBE. Gjithashtu me qëllim të intensifikimit për një bashkëpunim ndërkomunal në mes të komunave, MAPL ka zhvilluar diskutime me të gjitha komunat për të identifikuar nismat për bashkëpunim ndërkomunal. Si rrjedhojë, janë ndërmarrë 6 iniciativa për bashkëpunim ndërkomunal. Ndërsa, në kuadër të bashkëpunimit ndërkomunal ndërkombëtar, gjatë kësaj periudhe kohore janë ndërmarrë 2 iniciativa në mes të komunës së Podujevës dhe Ames në Iowa dhe në mes komunës së Rahovecit me dy komuna Arbëreshe në Itali atë të Frascineto dhe Civitta. Kurse, një marrëveshje është nënshkruar në mes të komunës së Gjilanit dhe Sioux City në Iowa

Zbatimi i programeve të bashkëpunimit ndërkufitar

Programi IPA II Kosovë-Shqipëri 2014-2020

Gjatë kësaj periudhe, janë kontraktuar dy projekte nga Thirrja e dytë për projekt propozime për prioritetin: Mbrojtja e ambientit, promovimi i përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, si dhe parandalimit dhe menaxhimit të rrezikut. Po ashtu, ka vazhduar implementimi i aktiviteteve të 5 projekteve nga Thirrja e parë për projekt propozime dhe 2 projekteve nga Thirrja e dytë për projekt propozime në të dy anët e kufirit deri në muajin Mars 2020. Pas kësaj, të gjitha aktivitetet janë ndërprerë për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID 19.

Po ashtu, është realizuar një takim bilateral në mes të Strukturave Operative të Shqipërisë dhe Kosovës me datë 28 Shkurt 2020 në Tiranë, ku është diskutuar mënyra e implementimit të Garantit të ri, është finalizuar ndarja e buxhetit, është finalizuar marrëveshja e partneritetit si dhe plani i aktiviteteve në vijim në kuadër të Programit KS-AL, është aprovuar AIR 2019 nga JMC dhe i njëjti është dërguar në Komisionin Evropian.

IPA II BNK Kosovë-Maqedoni 2014-2020

Gjatë kësaj periudhe (Janar - Mars 2020) janë kontraktuar tri projekte nga Thirrja e tretë për projekt propozime në vlerë të përgjithshme 1,417,056.36. Një projekt në vlerë: 447,144.92 vazhdon që të realizohet në kuadër të prioritetit "Inkurajimi i turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore" ndërsa dy projekte të tjera në vlerë: 929,911.44 do të realizohen në kuadër të prioritetit "*Mbrojtja e ambientit, promovimi i përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, si dhe parandalimit dhe menaxhimit të rrezikut*". Pesë projekte nga Thirrja e parë dhe e dytë për projekt propozime, si dhe 3 projektet e kontraktuara nga Thirrja e tretë kanë vazhduar me

implementimin e aktiviteteve të projekteve në të dy anët e kufirit deri në muajin Mars 2020. Pas kësaj, të gjitha aktivitetet janë ndërprerë për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID 19.

Po ashtu, është realizuar një takim bilateral në mes të Strukturave Operative Kosovës dhe Maqedonisë Veriore me datë 28 Shkurt 2020 në Tiranë, ku është diskutuar mënyra e implementimit të Grantit të ri, është finalizuar ndarja e buxhetit, është finalizuar marrëveshja e partneritetit, si dhe plani i aktiviteteve në vijim në kuadër të Programit KS-MK. Në kuadër të këtij programi është aprovuar AIR 2019 nga JMC dhe i njëjti është dërguar në Komisionin Evropian.

IPA II BNK Kosovë-Mali i Zi 2014-2020

Ka vazhduar implementimi i aktiviteteve të 7 projekteve nga Thirrja e parë në të dy anët e kufirit deri në muajin Mars 2020. Pas kësaj, të gjitha aktivitetet janë ndërprerë për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID 19. Ndërsa, Projektet nga Thirrja e dytë për propozime janë në proces të kontraktimit dhe qartësimit buxhetor.

Po ashtu, është realizuar takimi bilateral në Podgoricë, Mali i Zi, ku është diskutuar mënyra e implementimit të Grantit të ri, është finalizuar ndarja e buxhetit, është finalizuar marrëveshja e partneritetit, si dhe plani i aktiviteteve në vijim në kuadër të Programit KS-MNE. Në kuadër të këtij programi është aprovuar AIR 2019 nga JMC dhe i njëjti është dërguar në Komisionin Evropian.

Avancimi i politikave dhe i kornizës ligjore për vetëqeverisje lokale

Aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe që ndërlidhen me përmbushjen e objektivit 2 të Planit të Punës për vitin 2020, janë shtrirë në drejtim të:

- Hartimit të projektligjeve dhe akteve nënligjore të planifikuara;
- Konsultimit paraprak të akteve sektoriale;
- Takimeve të rregullta me komunat;
- Monitorimit të komunave;
- Adresimin dhe zbatimin e obligimeve nga agjenda evropiane;
- Raporteve të hartuara;
- Koordinimit të politikave; dhe
- Zbatimit të rekomandimeve të Auditorit

Zhvillimi i akteve ligjore dhe nënligjore

MAPL fokus të veçantë i ka dhënë edhe akteve nënligjore në programin legjislativ për vitin 2020 dhe dokumenteve tjera, si në vijim:

- Plotësim ndryshimi i Rregullores për performancë komunale – është miratuar vendimi për themelimin e grupit punues dhe është hartuar drafti fillestar;
- Projekt rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës - është miratuar vendimi për themelimin e grupit punues dhe është hartuar drafti i parë;
- Projekt Udhëzimi Administrativ (MAPL) për procedurën e Emërimit të Nënkrjetarëve në Komuna - është miratuar vendimi për themelimin e grupit punues dhe është hartuar drafti i parë;
- Projekt Udhëzim Administrativ për Sekretarët e Kuvendeve të Komunave - është miratuar vendimi për themelimin e grupit punues;
- Projekt Udhëzimi Administrativ (MAPL) për Transparencë në Komuna - është miratuar vendimi për themelimin e grupit punues;
- Projekt Udhëzimi Administrativ (MAPL) për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë - është miratuar vendimi për themelimin e grupit punues dhe është hartuar drafti i parë;
- Vlerësimi Ex-post i Ligjit për zgjedhje lokale - është miratuar vendimi për themelimin e grupit punues dhe është hartuar drafti i parë;
- Është hartuar Qarkorja Ligjore për zbatimin e Vendimeve të Qeverisë për parandalimin e COVID-19. Kjo Qarkore i ka pezulluar gati të gjitha aktivitetet e komunave.

Vlerësimi i ndikimit të politikave në fushën e vetëqeverisjes lokale

Gjatë kësaj periudhe MAPL ka zhvilluar disa takime me partnerin zbatues (DEMOS) për të diskutuar përmbajtjen e Raportit mbi Studimin e Fizibilitetit të Vetëqeverisjes Lokale i cili është përfunduar nga ekspertët dhe i njëjti është dërguar tek zyra e Sekretares së Përgjithshme të MAPL-së për aprovim. Ky raport

ka për qëllim diagnostifikimin e sistemit ekzistues të vetëqeverisjes lokale në Kosovë bazuar në parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale. Gjithashtu, ka filluar faza e dytë e studimit të fizibilitetit e cila do të jep alternativat për zhvillimin dhe avancimin e mëturjes së vetëqeverisjes lokale në Kosovë.

Sa i përket konsultimit paraprak të akteve të ministrive sektoriale dhe përputhshmërisë së tyre me legjislacionin për vetëqeverisje lokale, janë përgatitur gjithsej 9 deklarata harmonizuese, janë dhënë komente në dy deklarata dhe janë mbajtur 4 takime të grupit punues për këto akte. Gjithashtu, MAPL në periudhën Janar- Mars 2020 ka pranuar dhe trajtuar 3 shkresa ligjore, 17 shkresa njoftuese, 20 përgjigje në ankesat e pranuar nga personat fizik dhe juridik dhe janë vlerësuar 3 marrëveshje të bashkëpunimit ndërkomunal.

Monitorimi i kuvendeve të komunave

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 93 mbledhje në 38 kuvende të komunave, prej tyre 85 mbledhje të rregullta, 4 të jashtëzakonshme dhe 4 mbledhje solemne. MAPL ka monitoruar përmes teleprezencës 88 mbledhje të mbajtura ose 94.6% e tyre, kurse 5 mbledhje të tjera janë monitoruar me prezencë fizike të zyrtarëve për monitorim në komunat: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Novobërdë, Zubin Potoku dhe Zveçan. Kuvendet e komunave kanë aprovuar gjithsej 330 akte. Prej tyre, 122 janë proceduar për vlerësim të ligjshmërisë në ministrinë e linjës, kurse 208 janë shqyrtuar nga MAPL. 100 % e akteve të kuvendeve u janë nënshtruar procesit të shqyrtimit administrativ të ligjshmërisë. Gjatë procesit të shqyrtimit të ligjshmërisë janë konstatuar 17 akte të kundërligjshme të kuvendeve të komunave, për të cilat janë dërguar 17 kërkesa për rishqyrtim. Si rrjedhojë 4 akte janë harmonizuar nga kuvendet e komunave (apo 23%), ndërsa 9 janë brenda afatit kohor për rishqyrtim (53% në proces). Bazuar në nenin 82.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, MAPL ka ndërmarrë veprimet procedurale për kundërshtim të 4 akteve (apo 23%) në gjykatën themelore, përmes Ministrisë së Drejtësisë.

Bazuar në nenin 86 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, MAPL është e obliguar të hartoj dhe dorëzoj në Qeveri dhe Kuvend të Republikës së Kosovës, Raportin vjetor të funksionimit të komunave. Ky raport është dërguar në Qeveri, Presidencë dhe Kuvend me datën 28 Mars 2020. Mirëpo, për shkak të pandemisë së COVID 19 nuk është mbajtur ceremonia e publikimit të këtij raporti, megjithëse raporti nxjerr 36 rekomandime të përgjithshme të dedikuara për komunat.

Adresimi i obligimeve nga agjenda evropiane

Lidhur me përmbushjen e obligimeve nga agjenda evropiane në këtë periudhë janë zhvilluar këto aktivitete, si:

- Është përfunduar Raporti vjetor i përmbushjes së Obligimeve të Komunave nga Agjenda Evropiane për vitin 2019;
- Është përgatitur Raporti i PKZMSA-së për periudhën Janar-Dhjetor 2019 dhe është lansuar në platformën online të MIE-së;
- Është përditësuar Inputi për Raportin e KE-së për Kosovën për vitin 2020 me të dhëna shtesë për periudhën raportuese: 1 Nëntor 2019 – 15 Shkurt 2020;
- Janë nxjerrë konkluzionet e komiteve: a) konkluzionet e dala nga Takimi i tretë i Komitetit të Stabilizim-Asociimit dhe b) konkluzionet e nën-komitetit për drejtësi, liri dhe siguri.
- Në vazhdimësi janë përgatitur informata për vizitat e Ministres së MAPL-së në komuna.

Me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile dhe donatorët rreth procesit të integritimit evropian, gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 5 takime me donatorë: Romacted, GIZ dhe OSBE. Gjithashtu, është ofruar mbështetje njësisive të MAPL-së dhe komunave lidhur me identifikimin e nevojave për të tyre për aplikim, përgatitjen e projekteve për aplikim në instrumentin e TAIEX-it, për fushat të cilat mbështet TAIEX si dhe për mënyrën e aplikimit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka bërë koordinimin e aktiviteteve me komuna për adresimin dhe zbatimin e obligimeve të cilat burojnë nga agjenda e integritimit evropian. Janë përcaktuar të gjitha obligimet e komunave në këtë fushë përmes programeve të veçanta të strukturuar në bazë të 3 kritereve kryesore të integritimit: a) politike, b) ekonomike dhe c) standardeve evropiane. Komunitat kanë ofruar informata duke u bazuar në planet individuale të hartuara dhe dokumenteve tjera relevante. Rezultatet e punës së komunave janë përmbledhur në Raportin për përmbushjen e obligimeve të komunave nga agjenda evropiane Janar-Dhjetor 2019. Në bazë të të dhënave të paraqitura në raport, MAPL ka nxjerrë mesataren e nivelit të përmbushjes së obligimeve për komunitat e Republikës së Kosovës ku komunitat kanë arritur që të përmbushin 69% të obligimeve të tyre. Ndërsa, përqindja e përmbushjes së kritereve në bazë të fushave kryesore është si vijon: a) kriteret politike - komunitat kanë arritur të përmbushin 71% të obligimeve nga agjenda evropiane, b) kriteret ekonomike - komunitat kanë përmbushur gjithashtu 71% të obligimeve dhe c) standardet evropiane - komunitat kanë arritur që të përmbushin 66% të obligimeve që dalin nga Agjenda Evropiane.

Koordinimi i politikave

Gjatë periudhës raportuese ka përfunduar hartimi i planit të punës së MAPL-së për vitin 2020. Është siguruar harmonizimi i planit të detajuar të punës së MAPL-së me planin e punës së Qeverisë dhe i njëjti është dërguar pran sekretariatit koordinues të qeverisë. Gjithashtu, është mbajtur takimi i departamenteve dhe njësisive organizative të MAPL-së për koordinimin e aktiviteteve të planifikuara në vitin 2020, si dhe për hartimin e planit të përbashkët me DEMOS për vitin 2020 dhe projeksioneve 2020-2021. Një plan i ngjashëm është hartuar edhe OSBE-në. Është siguruar identifikimi i prioriteteve strategjike të MAPL-së të cilat dalin si obligime nga Strategjia për Vetëqeverisje Lokale, strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal, SKZH, PKZMSA, ERA, si dhe dokumentet e tjera sektoriale. Të gjitha janë marrë për bazë gjatë hartimit të planit të punës për vitin 2020. Në këtë periudhë ka filluar edhe identifikimi i prioriteteve afatmesme strategjike, për të vazhduar me hartimin e planit 3-vjeçar të punës së MAPL-së. Kurse, bazuar në kërkesat e qeverisë për raportim, është përgatitur edhe raporti lidhur me zbatimin e PVPQ-së për periudhën Janar- Mars 2020, në mënyrë që të jetë i gatshëm në momentin që kërkohet nga SKQ-ja.

MAPL ka përfunduar raportin për zbatimin e strategjisë për vetëqeverisje lokale 2016 – 2026 për periudhën Janar – Dhjetor 2019 dhe janë përgatitur të gjitha detajet për organizimin e takimit me grupin punues ndërmësor të Strategjisë me përkrahje nga OSCE, por për shkak të pandemisë së shfaqur në vend, takimi është shtyrë për periudhën Prill – Qershor 2020. Rëndësi të veçantë kanë pasur edhe hartimi i një mori raportesh, analizash, dokumentesh, e të tjera të cilat janë produkt i MAPL-së, si:

- Raporti Vjetor i punës së MAPL Janar-Dhjetor 2019
- Raporti vjetor i funksionimit të komunave Janar – Dhjetor 2019;
- Raporti i të arriturave të MAPL-së për vitin 2019;
- Analiza e realizimit të planit të punës së MAPL-së për periudhën Janar Dhjetor 2019;

- Raport për zbatimin e rekomandimeve të auditorit (të jashtëm dhe të brendshëm) për vitin 2018 dhe për periudhën Janar – Dhjetor 2019;
- Është përgatitur lista e rreziqeve e MAPL-së për periudhën Janar – Dhjetor 2019;
- Është përgatitur lista e vetëvlerësimit të MAPL-së për periudhën Janar – Dhjetor 2019;
- Është publikuar raporti përmbledhës për investimet kapitale në komuna për vitin 2019;
- Janë përgatitur raportet e investimeve kapitale në komuna për periudhën 2017-2019 dhe periudhën 2008-2019;
- Raporti vjetor lidhur me shpenzimet komunale dhe realizimin e të hyrave vetanake të komunave për vitin 2019.

Zbatimi i rekomandimeve të auditorit

Sipas Raportit vjetor Janar–Dhjetor 2019 për zbatimin e rekomandimeve të auditorit (të jashtëm dhe të brendshëm) gjithsej kanë qenë: 7 të gjetura, 66 rekomandime dhe 67 veprime të planifikuara, të cilat të gjitha janë realizuara në bazë të informatave të ofruara. Nga Auditori i jashtëm kemi: 7 rekomandime, 8 veprime të planifikuara dhe 8 veprime të zbatuara. Ndërsa, nga Auditori i brendshëm kemi: 59 rekomandime, 59 veprime të cilat të gjitha janë zbatuar ose janë ofruar informata mbi zbatimin e tyre. Të gjitha informatat janë pasqyruar në raportin për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit.

Ngritja e transparencës komunale, promovimi i të drejtave të njeriut dhe zhvillimi i kapaciteteve

Aktivitetet e realizuara gjatë kësaj periudhe (Janar – Mars 2020) janë ato të cilat ndërlidhen me:

- Monitorimin e fushës së të drejtave të njeriut në komuna;
- Forcimin e transparencës komunale;
- Monitorimit të ueb-faqeve komunale;
- Monitorimit të zbatimit të ligjit për qasje në dokumentet zyrtare në komuna;
- Implementimit të standardeve të konsultimit publik në komuna;
- Bashkëpunimit me shoqërinë civile.

Aktivitetet në fushën e të drejtave të njeriut

MAPL ka vazhduar me mbështetjen e komunave në zbatimin e politikave në fushën e të drejtave të njeriut. Në këtë periudhë është hartuar Raporti vjetor për të drejtat e njeriut për periudhën e vitit 2019. Në kuadër të këtij raporti përfshihen të dhënat për të drejtat e fëmijëve në komuna, të drejtat e komuniteteve. Në proces të hartimit është raporti për zbatimin e ligjit për barazi gjinore në komuna, raporti për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore, raporti për të drejtat e komuniteteve jo shumicë, si dhe raporti për të drejtat e personave me aftësi (nevoja) të kufizuara (veçanta). Në kuadër të promovimit të drejtave të njeriut në nivel lokal, MAPL në bashkëpunim me komunën e Vitisë kanë filluar realizimin e projektit në identifikimin e qasjes fizike për personat me aftësi të kufizuara në këtë komunë.

Forcimi i transparencës komunale

Forcimi i transparencës dhe qeverisja elektronike kanë qenë ndër objektivat kryesore të kësaj periudhe. Në këtë segment, MAPL ka finalizuar planin e monitorimit për transparencë në komuna dhe janë identifikuar të gjithë treguesit e transparencës që dalin nga legjislacioni primar dhe sekondar. Plani identifikon njësitë kryesore të MAPL-së përgjegjëse për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të transparencës. Plani është në harmoni me Sistemin e menaxhimit të performancës komunale.

Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar monitorimi i ueb-faqeve të komunave për të parë nivelin e përmbushjes së obligimeve për informimin e publikut sipas kriterëve të kërkuara ligjore. Është hartuar raporti Janar -dhjetor 2019 i monitorimit të ueb-faqeve të komunave. Janë siguruar të dhënat për komunat rreth publikimit të rregulloreve dhe vendimeve të kuvendit komunal, vendimeve të kryetarit të komunës, procesverbaleve, njoftimeve për mbledhje të kuvendit komunal, njoftimeve për debate publike, transparenca në aktivitetet e prokurimit, transparenca financiare, si dhe përmbushja e obligimit ligjor në përdorimin e gjuhëve zyrtare të komunave. Sipas raportit komunat kanë publikuar rreth 68% të rregulloreve të aprovuara dhe 52% e procesverbaleve të mbledhjeve të kuvendeve të komunave. Sa i përket krahasimeve në mes të komunave, 33 komuna ose 87% e komunave kanë publikuar akte të kuvendit komunal, ndërsa 5 komuna ose 13% e komunave nuk kanë publikuar asnjë akt në faqet e tyre zyrtare gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019 (Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Mitrovicë Veriore dhe Shtërpçë).

Po ashtu, në këtë periudhë është themeluar grupi punues për plotësim ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2018 për transparencë në komuna. Janë mbajtur 2 takime me grupin punues. Është hartuar analiza për ndryshimet që kërkohen t'i ketë ky udhëzim administrativ. Ky dokument është shpërndarë te grupi punues dhe është dhënë afati për komente. Pas marrjes së komenteve, do të vazhdohet puna me draftimin e dispozitave të udhëzimit administrativ sipas afateve ligjore.

Informimi i publikut për aktivitetet e MAPL-së

Gjatë kësaj periudhe MAPL ka ofruar informata të vazhdueshme për publikun, mediet, shoqërinë civile, organizatat e huaja ndërkombëtare, si dhe palët e interesuara lidhur me aktivitetet e zhvilluara. Sipas të dhënave, numri i informatave është si në vijim:

- 86 Lajme të publikuara dhe 20 aktivitete ditore;
- 106 Informata të publikuara në ueb faqen zyrtare të MAPL-së;
- 106 Informata të publikuara në rrjetin social facebook dhe 26 të tjera në twitter;
- 2 Informata lidhur me realizimin e aktiviteteve të mbajtura nga grupet punuese me rastin e hartimit dhe plotësim ndryshimit të akteve nën ligjore;
- 93 Konfirmime të ligjshmërisë së akteve të komunave;
- 25 Njoftime për media dhe 2 ftesa për media;
- 18 Njoftime (konkurse) për vende të lira pune;
- 5 Njoftime dhe kontrata të prokurimit publik;
- 3 Thirrje për projekt propozime;
- 62 Pasqyrime ditore të mediave elektronike në gjuhën shqipe dhe serbe;
- 1 Fletë informative e hartuar dhe e publikuar në ueb-faqe;
- 1 Plan i komunikimit të MAPL-së i hartuar;
- 4 Kërkesa për qasje në dokumente publike të pranuar dhe aprovuar;
- 3 Raporte të publikuara;
- 1 Raport për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2019;
- 6 Raporte për publikimin e informatave në faqen zyrtare të MAPL-së në facebook;
- 13 Pyetje të parashtruara nga mediet dhe 13 përgjigje të ofruara për media;
- 1 Takim i përbashkët i mbajtur me Zyrat për Komunikim Publik të Komunave dhe Ministrive të linjës;
- 4 Takime me Zyrat për Komunikim Publik të Komunave me qëllim të zhvillimit të trajnimeve për promovimin e MSA-së në nivel lokal.

Raporti për qasjen në dokumentet publike në komuna

MAPL ka hartuar Raportin krahasues për qasje në dokumente publike në komuna për vitin 2018-2019. Raporti thekson se gjatë kësaj periudhe, komunave u janë parashtruar 1101 kërkesa nga qytetarët. Prej tyre, komunat kanë lejuar qasje në 1062 kërkesa (apo 96%), 28 janë refuzuar (3%), si dhe 11 janë aprovuar pjesërisht (1.86%). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018, në vitin 2019 numri i kërkesave për qasje në dokumentet publike ka treguar rritje për 17% apo për 137 kërkesa më shumë.

Gjithashtu, është hartuar Raporti për qasje në dokumentet publike për periudhën Janar-Dhjetor 2019. Raporti pasqyron se komunat kanë treguar trend pozitiv në lejimin e qasjes në dokumente publike sipas kërkesave të parashtruara nga subjektet juridike, si dhe Ex-Officio kur ligji këtë e kërkon. Numri total i kërkesave të

parashtruara është 1101, prej tyre me qasje të lejuar janë 1062 kërkesa (apo 96%), 28 janë të refuzuara (3%), 11 të lejuara pjesërisht (1%). 5 komuna nuk kanë pasur asnjë kërkesë të parashtruar (Dragashi, Leposaviq, Zveçan, Klllokot dhe Zubin Potok).

Krijimi i platformës së kontrollit të brendshëm dhe transparencës buxhetore

Lidhur me implementimin e projektit (platformës online) për rritjen e llogaridhënies institucionale dhe transparencës buxhetore, në vlerë prej 60 mijë euro bashkëfinancim me ambasadën britanike MAPL ka pranuar një kërkesë nga UNDP me ç'rast janë kërkuar sugjerimet se si të veprohet tutje lidhur me nënshkrimin e kontratës për zhvillimin e platformës. Pas konsultimeve të zhvilluara ndërmjet MAPL-së, Ambasadës Britanike dhe UNDP-së, është vendosur që të vazhdohet tutje me procedurën e nënshkrimit të kontratës me kompaninë përfituese *Komtel Project Engineering*. Me kërkesë të UNDP-së po ashtu është mbajtur takimi i përbashkët ndërmjet përfaqësuesve të MAPL-së me përfaqësuesit e UNDP-së, si dhe ekspertit të TI-së i cili ka përgatitur ToRs për platformën ‘*Rrija e kontrollit të brendshëm dhe transparencës buxhetore e shpenzimeve të fondeve publike të MAPL-së*’. Kjo ka ardhur si rezultat i kërkesës së kompanisë fituese e cila ka kërkuar sqarime shitesë dhe qartësime lidhur me procesin e zhvillimit dhe funksionalizimit të platformës.

Gjithashtu, një takim tjetër është mbajtur ndërmjet përfaqësuesve të MAPL-së, Ambasadës Britanike, UNDP-së dhe kompanisë përfituese Komtel lidhur me zhvillimin dhe funksionalizimin e platformës. UNDP ka nënshkruar kontratën me kompaninë përfituese *Komtel Project Engineering* e cila ka marrë përsipër të përgatis Planin Dinamik, si dhe Planin e Detajuar. Kompania është duke mbajtur takime të rregullta me departamentet dhe njësitë organizative të MAPL-së nga distanca me qëllim të konkretizimit të veprimeve dhe zhvillimit të platformës. Njëkohësisht është njoftuar edhe Thesari i Kosovës se zhvillimi dhe funksionalizimi i kësaj platforme nuk e afekton Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës (SIMFK) pas shpjegimeve dhe qartësimeve të bëra për proceset që do të zhvillohen përmes platformës. Përmes platformës me automatizëm kalohet nga proceset manuale në procese të digjitalizuara dhe me këtë, arrihet funksionimi më i mirë i kontrollit të brendshëm dhe transparencës buxhetore, si dhe ka thjeshtëzim të veprimeve duke racionalizuar kohën përgjatë përdorimit të platformës.

Platforma e brendshme e raportimit

Ka vazhduar raportimi online në sistemin e integruar i monitorimit dhe raportimit. Në mënyrë sistematike është vendosur plani vjetor i punës së MAPL-së për vitin 2020. Ndërsa, në të njëjtën kohë ka vazhduar procedimi i akteve të cilat i nënshtrohet procesit të vlerësimit të ligjshmërisë.

Bashkëpunimi me shoqërinë civile

MAPL vazhduar me përfshirjen e shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe legjislacionit për vetëqeverisje lokale, në monitorimin e proceseve rekrutuese, si dhe implementimin e strategjisë për vetëqeverisje lokale 2016-2026. Gjatë kësaj periudhe MAPL ka mbajtur takimin me Forumin Konsultativ me organizatat e shoqërisë civile me qëllim të diskutimit të fushave që prekin vetëqeverisjen lokale në Kosovë.

Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunal

MAPL në pajtim me objektivat e strategjisë për vetëqeverisje lokale, gjegjësisht forcimit të kapaciteteve institucionale të komunave, ka ndërmarrë veprime për zbatimin e aktiviteteve të parapara në këtë fushë. Në këtë drejtim, janë organizuar 2 takime me IKAP dhe donatorë (*UNDP, GIZ, USAID, OSBE dhe DEMOS*) për të koordinuar aktivitetet rreth organizimit të trajnimeve për komuna komform planit të trajnimeve dhe për të ofruar përkrahje në realizimin e planit të trajnimeve dhe vlerësimin e nevojave për trajnime. Ndërsa, në bashkëpunim me projektin GIZ në këtë periudhë MAPL ka realizuar trajnime në 7 komunat e Republikës së Kosovës me temën “*Komunikimi i masave të MSA-së në nivel lokal*”, ku pjesëmarrës kanë qenë 80 zyrtarë komunal.

Administrata, financat dhe prokurimi

Administrata dhe financat

Gjatë kësaj periudhe progres është shënuar edhe në fushën e administratës dhe financave në MAPL. Kësisoj është bërë përgatitja e fletëpranimit standard të parasë së imët dhe vendosja e të dhënave për kërkesat e bërë për *Petty Cash*. Në vazhdimësi është bërë pranimi i kërkesave iniciuese për zotimin e mjeteve në SIMFK, regjistrimi i zotimeve dhe i shpenzimeve në SIMFK, po ashtu janë pranuar lëndët dhe faturat për procedim të pagesave dhe të njëjtat janë evidentuar në kalendarin elektronik. Po ashtu, është analizuar dhe harmonizuar me raportet e brendshme barazimi i regjistrimit të shpenzimeve me Departamentin e Thesarit në Ministrinë e Financave që përfshinë kontrollimin e raportit të SIMFK-së. Gjatë kësaj periudhe janë dorëzuar raportet e kontabilitetit për periudhën Janar dhe Shkurt 2020 mbi shpenzimet e përgjithshme. Buxheti final i MAPL-së (bazuar në raport të datës 06.04.2020) së bashku me Donacionin është 4,893,832.89 €, ku nga kjo shumë për periudhën Janar –Mars janë shpenzuar 260,057.21 € ose 5.60% e buxhetit. Ndërsa prej kategorisë së donacionit është shpenzuar shuma 12,198.46 EUR ose 4.91% e buxhetit. Në total Buxheti i MAPL-së + Donacionet për periudhën janar-mars është shpenzuar në vlerë prej: 272,255.67 ose 5.56 %.

Buxheti i MAPL-së për vitin 2020 është 4,893,832.89 €, ku nga kjo shumë për periudhën Janar –Mars janë shpenzuar 260,057.21 € ose 5.60% e buxhetit

Është ofruar ndihmë në përkthim të materialeve, dokumenteve të ndryshme në gjuhën serbe dhe angleze është ofruar përkthim simulant në takime të ndryshme të cilat kanë i kanë zhvilluar njësitë e MAPL-së. Po ashtu, janë ofruar shërbime në transport, shpërndarje të materialeve të ndryshme dhe fotokopje.

MAPL, ka filluar zbatimin e planit të personelit për vitin 2020, janë iniciuar në vazhdimësi kërkesat për rekrutimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për pozita të lira me ç'rast me mbështetje nga Ambasada Britanike përmes partnerit zbatues "BIRN", është implementuar projekti monitorues për pozitat e shërbyesve civil lidhur me procesin e rekrutimit në MAPL. Në këtë periudhë, janë zhvilluar 8 procedura të rekrutimit, ku nga 8 procedura BIRN ka monitoruar tre procedura të rekrutimit. Gjithsej nga 8 procedura të zhvilluara janë përzgjedhur gjithsej 5 kandidatë. Prej tyre 4 femra dhe 1 mashkull. Po ashtu, 2 pozita janë anuluar dhe një pozitë tjetër është pezulluar.

Ka vazhduar kompletimi i dosjeve të zyrtarëve në MAPL lidhur me kërkesat iniciuese për procedurat e rekrutimit për pozitat e lira, si dhe është bërë njoftimi në faqen zyrtare të MAPL-së. Është përditësuar baza elektronike me të dhëna për stafin e MAPL-së, është bërë menaxhimi i udhëtimeve zyrtare, inventarizimi i dosjeve personale, menaxhimi i pushimeve vjetore, mjekësore, etj. MAPL ka koordinuar aktivitetet me IKAP-in sa i përket fushës së trajnimeve të stafit. Me qëllim të involvimit të të rinjve në politikbërje dhe vendimmarrje, gjatë vitit 2020 në MAPL gjithsej 7 praktikantë kanë ndjekur praktikën, prej tyre 3 praktikantë (2 femër dhe 1 mashkull) si rezultat i Marrëveshjes së Mirëkuptimit në mes të MAPL-së dhe MPMS (Agiensioni i Punësimit) dhe 4 praktikantë të tjerë (3 femra dhe 1 mashkull) sipas kërkesës së tyre. Lidhur me numrin e përgjithshëm të punonjësve në MAPL, sipas të dhënave në periudhën Janar – Mars 2020, numri i punonjësve në Ministri është 140, prej tyre 16 punonjës janë staf politik dhe 124 shërbyes civil. Prej 124 shërbyesve civil 65 janë meshkuj ose 52.42%; dhe 59 femra ose 47.58%. Ndërsa, sa i përket përkatësisë etnike janë: 95 shqiptarë ose 76.61%, 27 serb ose 21.77% dhe 2 turq ose 1.61%. Lidhur me pozitat udhëheqëse kemi

këto të dhëna: 1 sekretare është femër, 2 udhëheqëse të departamenteve janë femra dhe 10 udhëheqëse të divizionit. Ndërsa, meshkuj janë 4 udhëheqës të departamentit dhe 8 udhëheqës të divizioneve.

Prokurimi

Gjatë periudhës Janar-Mars 2020, njësia e prokurimit ka zhvilluar aktivitetet e saj të planifikuara. Sipas të dhënave nga njësia përkatëse, prej 5 aktiviteteve të zhvilluara të prokurimit, 1 ka qenë kuotim çmimesh dhe 4 janë kuotime të çmimeve me vlerë minimale (blerje minimale).